



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave -Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2019



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave -Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2019



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi : Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit : Tetor, 2020

© Agjencia e Statistikave të Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata më të shumta janë në dispozicion në internet, ku mundë të qaseni
përmes web-faqes së ASK- së

web-faqe: <http://ask.rks-gov.net/> dhe Tel.+381(0) 200 31-120

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara (AMT) për vitin referues 2019, si anketë e rregullt vjetore. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të sigurohen të dhëna të qëndrueshme statistikore për sektorin e mbeturinave në Kosovë.

Rezultatet e paraqitura në këtë publikim ofrojnë burim të rëndësishëm statistikor të gjendjes aktuale të këtij sektori. Metodologjia e përdorur për realizimin e anketës është në përputhje me rregulloret dhe rekomandimet e BE-së, duke përfshirë Ligjin për Mbeturinat në Kosovë (Nr. 02/L-30).

Publikimin e përgatitën:

Bajrush Qevani, Drejtori i DSBM-së

Haki Kurti, Shef i Divizionit të Statistikave të Mjedisit

Flutura Shosholli, Zyrtare e Statistikave të Mjedisit

Sugjerimet, propozimet dhe komentet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura. Ato mund të dërgohen në e-mail:

agricultural@rks-gov.net

Tetor, 2020

Zv. Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së

Ilir T. Berisha

Shkurtesat dhe Simbolet

BE Bashkimi Evropian

ASK Agjencia e Statistikave të Kosovës

DSBM Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

AMT Anketa e Mbeturinave të Trajtuar

KPK Kompanitë Publike Komunale

Simbolet

kg - Kilogram

t - Ton

% - Përqindje

Përmbajtja

1. Objektivi dhe metodologjia e anketës.....	5
1.1 Objektivi.....	5
1.2 Metodologjia	6
1.2.1 Korniza e anketës.....	6
3. Rezultatet.....	7

1. Objektivi dhe metodologjia e anketës

1.1 Objektivi

Qëllimi i anketës së mbeturinave të trajtuara 2019 është që të sigurojë informacion mbi mbeturinat sipas kategorive si vijon:

- Sasisë së mbeturinave të deponuara
- Sasisë së mbeturinave të ricikluara dhe
- Sasisë së mbeturinave të sterilizuara

Objektivi i AMT 2019 ka qenë grumbullimi i të dhënave statistikore nga bizneset të cilat merren me trajtimin e mbeturinave (deponitë regjionale, objektet e trajtimit të mbetjeve spitalore, sterilizimi dhe objektet e trajtimit të mbeturinave industriale).

Gjithashtu, ky publikim synon të sigurojë bazën për monitorimin e trajtimit të mbeturinave në të ardhmen në këtë sektor.

1.2 Metodologjia

1.2.1 Korniza e anketës

Metodologjia për realizimin e anketës në terren është përgatitur gjatë periudhës prill-maj 2019. Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dokumentet si vijon: pyetësori dhe udhëzuesi për intervistuesit dhe mostra e anketës. Mostra është nxjerrë nga regjistri i biznesit në ASK.

Në këtë anketë janë përfshirë bizneset të cilat merren me trajtim të mbeturinave. Bizneset aktivitetet e të cilëve kufizohen në mbledhjen dhe tregtimin e mbeturinave të riciklueshme (kryesisht bizneset që i përkasin E38 dhe G46.77) në AMT 2019 nuk janë përfshirë.

1.2.2 Procedurat në terren

Puna në terren u krye gjatë periudhës kohore korrik-gusht 2020, nga anketuesit të cilët zhvilluan intervista të drejtpërdrejta me menaxherët e kompanive, në bazë të pyetësorëve. (Shtojca 1). Gjithashtu gjatë periudhës së lartpërmendur janë zhvilluar edhe aktivitete si në vijim:

- Mbikëqyrja dhe kontrollimi i pyetësorëve të plotësuar në terren nga mbikëqyrësi.
- Kontrollimi cilësor i pyetësorëve të plotësuar në zyrën qendrore në ASK, stafi i Divizionit të Statistikave të Mjedisit.

2. Definicioni

Trajtimi i mbeturinave: përfshinë përpunimin për deponimin përfundimtar, duke përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose deponimit përfundimtar.

Trajtimi i mbeturinave përfshin trajtimin fizik, kimik, biologjik apo termik, duke përfshirë sortimin, që ndryshon karakteristikat e mbeturinave në mënyrë që të zvogëlohet vëllimi, lehtësohet trajtimi ose riciklimi i mbeturinave.

3. Rezultatet


Tabela më poshtë tregon sasinë e mbeturinat të deponuara, të ricikluara, të sterilizuara dhe gjithsej sasinë e mbeturinave të cilat trajtohen në Kosovë.

Tabela 1: Mbeturinat e trajtuara sipas llojit për vitin 2019 /t.

Mbeturinat	Deponuar	Ricikluar	Sterilizuar	Gjithsej
Mbeturinat spitalore			874	874
Mebeturinat e letrës dhe kartonit		248		248
Mbeturinat nga metalet		2.479		2.479
Mbeturinat nga plastika		1.027		1.027
Mbeturinat nga ekonomitë familjare dhe të ngjashme	445.547			445.547
Gjithsej	445.547	3.754	874	450.175

Të dhënat në tabelën 1, tregojnë se gjithsej sasia e mbeturinave të deponuara për vitin 2019 ka qenë 445,547 ton, sasia e mbeturinave të ricikluara ka qenë 3.754 ton, sasia e mbeturinave të sterilizuara¹ (që u takon në përgjithësi mbeturinave spitalore) ka qenë 874 ton dhe sasia gjithsej e mbeturinave të trajtuara dhe të deponuara për vitin 2019 ka qenë 450.175 ton.

Grafi 1: Mbeturinat e trajtuara sipas llojit të trajtimit 2019/në %.



¹ Në kategorinë mbeturina të sterilizuara përfshihen mbeturinat spitalore nga Qendra Universitare e Kosovës si dhe nga spitalet Regjionale te Kosovës (Spitali i Gjilanit, Prizren, Gjakovë Ferizaj, Pejë, Vushtri dhe Mitrovicë)

Nga grafiku 1 vërehet për qindje më e lartë e mbeturinave nga metalet, 54% si dhe nga mbeturinat e plastikës 22%.

Të dhënat nga deponitë e licencuara janë të prezantuara në tabelën në vijim.

Tabela 2: Të dhënat e mbeturinave të grumbulluara në deponitë e licencuara për vitin 2019/t.

Deponitë/t	2019
DS Prishtinë	150.921
DS Ferizaj	25.166
DS Gjilan	41.574
DS Mitrovicë	53.729
DS Pejë	54.423
DS Prizren	104.058
DS Podujevë	15.676
Gjithsej:	445.547

Nga të dhënat në tabelën 2 vërehet se sasia e mbeturinave të deponuara në vitin 2019 ka qenë 445.547/t. Krahësuar me të dhënat e vitit 2018 ka një rritje prej 5%.

Grafiku 2: Sasia e mbeturinave në deponitë e licencuara




Tabela 1:Objektet për trajtim te mbeturinave 2019

Çfarë lloji të objektit për trajtimin e mbeturinave keni në përdorim	Ju lutemi shënjoni me kryq objektin /aktivitetin e duhur	KAPACITETI (ton/vit)	KAPACITETI I MBETUR NE FUND TË 2019 (m³)
1. Deponi	<input type="checkbox"/>		
2. Objekte për djegje	<input type="checkbox"/>		
3. Objektet në të cilat bëhet djegia e mbeturinave spitalore / mjekësore	<input type="checkbox"/>		
4. Shitja e materialeve te riciklueshme	<input type="checkbox"/>		
5.*	<input type="checkbox"/>		

* Ju lutem përdorni linjën 5 për llojet e tjera të objekteve

* kolonat e ngjyosura nuk plotësohen

Tabela 2:Të dhënat e mbeturinave të trajtuara (të cilat i nënshtrohen procesit të trajtimit)

Mbeturinat të cilat hyjnë në objekte për trajtim				
Lloji i mbeturinave/ Produkti (Përshkrimi)	Kodi i mbeturinave (kodi i LpM)	Sasia e gjeneruar	nga e cila ...	
			Mbeturinat e gjeneruara nga kompania	Mbeturina nga kompanitë tjera ose kompanitë e grumbullimit të mbeturinave
		ton	ton	ton
1	2	3	4	5
Gjithsej				

Tabela 3: Të dhënat e mbeturinave të trajtuara (të dalura nga procesi i trajtimit)

[illegible]

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

311: 628.54 (496.51) “2019”(084.2)

Anketa e Mbeturinave të Trajtuara 2019 / publikimin
e përgatitën Bajrush Qevani, Haki Kurti, Flutura
Shosholli. – Prishtinë : Agjencia e Statistikave të
Kosovës, 2020. – 13 f. : ilust. ; 24 cm. – (Statistikat e
Bujqësisë dhe Mjedisit ; Seria 2)

1.Qevani, Bajrush 2.Kurti, Haki 3.Shosholli,
Flutura

ISBN 978-9951-22-678-3

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Përshkrim i shkurtër

Agjencia e Statistikave të Kosovës, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Misioni i Agjencionit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë

Telefonat: +381 (0) 31 129

Kryeshefi ekzekutiv : +381 (0) 38 200 31 112

Fax: +381 (0) 38 235 033

E-mail: infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-22-678-3

